

Enver Hoxha

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



Vdiq Ramiz Alia



Ramiz Alia 18.10.1925-07.10.2011

Më 7 tetor 2011, në moshën 86 vjeçare, vdiq në spitalin e Senatoriumit në Tiranë Ramiz Alia, një nga udhëheqësit më të shquar të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe shtetit shqiptar, bashkëluftëtar dhe bashkëpunëtor i afërt i shokut Enver Hoxha, si gjatë luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ashtu edhe në epokën e ndërtimit të socializmit.

Ramiz Alia u lind më 18 tetor 1925 në një familje të varfër në Shkodër. Ka kryer studimet e larta më 1954. I detë komuniste i përqafoi që kur ishte nxënës në gjimnazin e Tiranës dhe mori pjesë aktive në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare si anëtar i Organizatës së Rinisë Komuniste të Shqipërisë që nga themelimi i saj. Në fillim të vitit 1943 bëhet anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ishte veprimtar i shquar i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, prandaj Partia e ngarkoi me përgjegjësi të rëndësishme në udhëheqje të Organizatës së Rinisë Komuniste. Në moshën 19-vjeçare iu besuan detyra me përgjegjësi politike e ushtarake në drejtimin e Brigadës së VII Sulmuese (1944), në Divizionin II Sulmues dhe si komisar i Divizionit V Sulmues (1944), i cili me urdhërin e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha, luftoi kundër fashizmit në çlirimin e trojeve shqiptare nën ish-Jugosllavinë por edhe në çlirimin e Jugosllavisë, duke plotësuar me besnikëri vijën internacionaliste të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në Kongresin e I të BRASH në Helmës (1944) u zgjodh anëtar i Sekretariatit të Rinisë dhe më pas, në Kongresin e Unifikimit të Rinisë (1949) u zgjodh Sekretar i parë i KQ të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

Pas çlirimit Ramiz Alia është ngarkuar për punë të palodhur, për aftësitë dhe cilësitë e tij si kuadër drejtues, me detyra me përgjegjësi të lartë Partie, shtetërore e shoqërore. Anëtar i KQ të PPSH që nga Kongresi I (1948), Ministër i Arsimit dhe i Kulturës (1955-1958), kandidat

i Byrosë Politike të KQ të PPSH në Kongresin III (1956) dhe anëtar i saj e Sekretar i KQ të PPSH nga Kongresi IV (1961). Sekretar i Parë i KQ të PPSH (1985), Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (1982), Komandant i Përgjithshëm I Forcave të armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes, nënkryetar i Frontit Demokratik të Shqipërisë (1967), Deputet në Kuvendin Popullor që nga legjislatura e dytë (1950).

Ramiz Alia ishte personalitet i shquar politik e shoqëror dhe burrë shteti. Ka luftuar dhe punuar kurdoherë me besnikëri e vendosmëri shembullore, për forcimin e Partisë e të pushtetit popullor, për ndërtimin me sukses të socializmit, për edukimin e komunistëve dhe të punonjësve me ideologjinë marksiste-leniniste, për zhvillimin e arsimit e të kulturës, të letërsisë e arteve dhe të shkencës.

Përkrah shokut Enver Hoxha, ai ka luftuar me konsekuencë dhe frymë internacionaliste të patundur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të vijës së Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit jugosllav, sovjetik e të gjitha ngjyrave. Ka zhvilluar me principialitet të lartë luftën klasore.

Ramiz Alia ishte luftëtar i vendosur për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendit, për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit kundër imperializmit e socialimperializmit dhe shërbëtorëve të tyre brenda dhe jashtë vendit. Ai ka mbrojtur dhe zbatuar me aftësi e pjekuri të lartë politikën e jashtme parimore revolucionare e paqedashëse të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe shtetit shqiptar.